

C.nr.465/2014

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE (ne objektin e Deges se kesaj Gjykate ne Vushtrri) gjyqtari Skender Shala, ne ceshtjen juridike te paditesit nga , te cilin e perfaqeson av. nga , sipas autorizimit me shkrim, kunder te paditurve nga tani me vendbanim te panjohur te cilin e perfaqeson perfaqesuesi I perkohshem Av. nga sipas Aktvendimit te kesaj gjykate dhe Komuna e , te cilin e perfaqeson , sipas autorizimit me shkrim, per vertetim pronesie, vlere e kontestit 3.002.00 Euro, pas mbajtjes se shqyrtimit kryesor dhe publik te dt.16.07.2015, bie kete:

AKT GJYKIM

I – VERTETOHET se paditesi nga është pronar i lokalit afarist ne siperfaqe te gabariteve prej **35.27m²** dhe i ipet e drejta e shfrytezimit te perhershem ne paluejtshmerine, si pjese e parceles katastrale nr. ne siperfaqe prej **43.64 m²**, ne te cilen eshte ndertuar lokali afarist, per perdorim dhe shfrytzim te rregullte te lokalit afarist, me kultur toke ndertimore, ne vendin e quajtur Rr.“ ”, me masat dhe kufijte qe jane shenuar ne skicen e terrenit te ekspertizes, e qe evidentohet ne emer te te paditures se dyte P.SH. Kuvendi Komunal I , ZK-


II – OBLIGOHEN te paditurit qe t'ia njohin kete te drejte paditesit dhe t'i lejojne qe paditesi kete paluejtshmeri ta regjistroje ne emer te tij, ne librat e tokes te Zyra Kadastrale Komunale ne , ne afatin prej 15 (pese mbledhjet) diteve, nga dita e pranimit te ketij aktgjykimi.

III. MASA E SIGURISE e caktuar me daten 20.02.2015, mbetet ne fuqi deri ne plotefuqishmerine e ketij aktgjykimi.

Secila pale i barte shpenzimet e veta te procedures kontestimore.

Arsyetim

Paditesi ne padin e tij te parashtuar si dhe nepermjet te autorizuarit te tij ne seancat e mbajtura ka theksuar se ne vitin 1993 , ne baze te kontrates gojore, e ka blere nga i padituri i pare nga paluejtshmerie e cekur si ne dispozitiv per cmimin kontraktues prej 3.000 DM, te cilin cmim ia ka paguar ne tersi dhe qe nga momenti i shitblerjes I njejti ka hyre menjehere ne posedim dhe shfrytezim te paluejtshmerise duke mos qene i penguar nga askush e te cilin edhe sot e shfrytezon. Ndersa ne vitin 2003 nderton lokalit afarist ne siperfaqe perj 75m².



Pasi qe i padituri i pare eshte ne adrese te panjohur i propozoj gijkates qe te ia caktoi perfaqesuesin e perkohshem.

I autorizuari i paditesit ne seancen e shqyrtimit kryesor beri precizimin e kerkespadise sipas ekspertzes se ekspertit gjeodet, kurse ne fjalen perfundimtare theksoi se nga provat e nxjerrura ne proceduren provuese ne menyre te pakontestueshme u vertetua bazushemeria e kerkespadise andaj gjykates I propozoj qe te njejten ta aprovoi te bazuar. Kete para se gjithash conform nenit 24 LTHMPJ lidhur me nenin 73 LMD-se.

Shpenzimet e procedures kontestimore nuk i kerkoi.

Ne baze te propozimit te autorizuarit te paditesit e conform nenit 79.1.3/a dhe 81.1 te LPK-es, gjykata me aktvendimin C.nr.465/2014 te dt.24.06.2015, te paditurit ia caktoi Perfaqesuesin e perkohshem, av. _____ nga _____ e cila ne baze te ketij aktvendimi do t'i ushtron te drejttat dhe detyrimet, conform nenit 82.1.2 te LPK-es.

Perfaqesuesi i perkohshem i te paditurit ne pergjigje te padise dhe precizimit te kerkespadise te paditesit ne shqyrtimin kryesor theksoi se fillimisht e kundershtoj padin dhe kerkespadin e paditesit, nuk e kundershtoj nxerrjen e provave, kurse ne fjalen perfundimtare deklaroi se Gjykates I propozoj qe conform rrezultatit te provave te bie vendim meritor lidhur me kete ceshtje juridike-civile.

Shpenzimet e procedures kontestimore nuk i kerkoi.


Perfaqesuesi I te paditures ne pergjigje te padise dhe precizimit te kerkespadise te paditesit ne shqyrtimin kryesor theksoi se se fillimisht e kundershtoj kerkespadine e paditesit si dhe ia len gjykates qe te vedos sipas provave qe I posedon, nuk e kundershtoj precizimin e kerkespadise nga ana e te autorizuarit te paditesit, nuk e kundershtojme nxerrjen e provave dhe propozimin per degjimin e deshmitareve, kurse ne fjalen perfundimtare deklaroi se Gjykates I propozoj qe conform rrezultatit te provave ne proceduren provuese te bie vendim meritor lidhur me kete ceshtje juridike-civile, duke pasur ne konsiderat natyren e regjimit juridik te paluajtshmerise dhe situaten ndertimore ne zonen perkatese urbanistike.

Shpenzimet e procedures kontestimore nuk i kerkoi.

Gjykata ne seancen e shqyrtimit kryesor, zhvilloi provat e propozuara dhe te nevojshme dhe pas administrimit dhe vlersimit te te njejtave ne kuptim te nenit 8 te LPK-es. erdhi ne perfundim se duhet vendosur si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi nga keto arsye.

Gjykata ne proceduren e provave lexoi: certifikaten e pronsise me nr. te lendes _____ e dt. 15.08.2014, procesvervbalin mbi vendshiqimin C.nr.465/14 te dt. 24.06.2015, ekspertizen e ekspertit gjeodet _____ ted t. 06.07.2015, beri veshtrim ne skicen e terenit nga I njejt ekspert gjeodet _____ ndegjoi deshmitaret _____ dhe _____ qe te dy nga _____ dhe konstatoi kete gjendje faktike:

Nga certifikata e pronesise e cekur me lart, konstatohet se parcela katastrale nr. _____ evidentohen ne emer te te paditures se dite _____



Nga procesverbali mbivendeshiqimin i kesaj gjykate te cekur me larte konstatohet se gjyqtari me vrojtım te drejtperdrejte ne vend konstatoi se paluajtshmeria kontestuese eshte e kufizuar dhe rrethekuar ne anen dhe me prone komunale, ndersa ne anen lindore me rruge te karakterit dytesor, kurse ne anen Perendimore me prone private. Ne kete paluajtshmeri eshte i ndertuar nje lokal afarist dy katesh. Ne kete lokal ushtrohet veprimtari per shitjen e teknikes se bardhe. Lokali eshte i ndertuar me material te forte ndertimor (sipas ekspertit gjeodet ne vendshiqim).

Nga konstatimi dhe mendimi i ekspertit gjeodet te cekur me lart, konstatohet se pas matjeve te kryera te pjeses kontestuese te paluajtshmerise nga ana e ekspertit gjeodet dhe ne baze te dokumentacionit, me te cilin posedon per momentin Drejtoria e Gjeodezise dhe Kadastrit ne , ka vertetuar se paluajtshmerija kontestuese bjen - gjegjesisht e perbene pjesen e parceles te cekur me larte me masa dhe kufij te shenuara si ne ekspertizen e dhene me shkrim dhe ne skicen e terenit, e cila eshte pjese perberse te kesaj ekspertize dhe te aprovuar si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

Nga skica e terenit e sipercekur shifet shtrirja, vendi, perkufizimi dhe siperfaqja e paluajtshmerise dhe lokalit afarist tani lendor.

Deshmitari deklaroi se e din se paditesi kete paluajtshmeri e ka blere paditesi nga nje person me emrin mbiemri I te cilit nuk me kujtohet ne vitin 1993, ne siperfaqe prej rreth 50 m2, me cmim te shitblerjes rreth 3.000 DM, te cilin cmim bleresi e di se paditesi ia ka paguar te gjitha te hollat shitesit per tere siperfaqen. E di se nuk kane nenshkruar kurrfar kontrate por shiteblerja eshte kryer sipas marreveshjes gojore. E di se paluajtshmeriaka nuk ka qene e rrethuar ne kohen e blerjes nuk ka pas te ndertuar asgje, por ne vitin 2003 paditesi ka ndertuar nje lokal ndertimin e te cilit e kam uidhehequr un me firmen ndertimore NNZ " " E di se paditesi ka hy ne posedim dhe shrfytezim te asaj paluajtshmerie qysh ne vitin 1993 dhe prej momentit te shitblerjes e deri me sot paditesi kurnjeher nuk ka pas ndonji problem, ndonji pengese apo kundershtrim e asaj paluajtshmerie e as ne lokalin e ndertuar me vone. Keto rrethana me jane te njohura sepse kam qene shoke me babain e paditesit pastaj edhe me djemt e tij dhe sic e ceka me larte une personalisht kam qene present gjat ndertimit te objektit nga se ne kohen e ndertimit si pedagog kam qene I papune dhe me eshte deshte te mirrem me punet e ndertimtarise. Ne pyetje te te autorizuarit te paditesit deshmitari pergjigjet: Jo, nuk di se ku gjindet tani I padituri!

Ne pyetje te parfaqesuesit te te paditures se dyle se a mundesh edhe njeher ta konfirmosh se ne cilin vit e ka blere paditesi kete paluajtshmeri, deshmitari pergjigjet: Ne vitin 1993.

Deshmitari deklaroi se ai se paditesi kete paluajtshmeri e ka blere nga nje person me emrin mbiemri I te cilit nuk me kujtohet ne vitin 1993, ne siperfaqe prej rreth 40 m2, me cmim te shitblerjes rreth 3.000 DM, te cilin cmim bleresi e di se paditesi ia ka paguar te gjitha te hollat shitesit per tere siperfaqen. E di se nuk kane nenshkruar kurrfar kontrate por shiteblerja eshte kryer sipas marreveshjes gojore por e kane lene qe me vone te perpilojne kontraten me shkrim. E di se paluajtshmeria nuk ka qene e rrethuar ne kohen e blerjes nuk ka pas te ndertuar asgje, por ne vitin 2003 paditesi ka ndertuar nje lokal pasiqe une kam punuar si elektricist ne ate lokal. E di se paditesi ka hy ne posedim dhe shrfytezim te asaj paluajtshmerie qysh ne vitin 1993 dhe prej momentit te shitblerjes e deri me sot paditesi kurnjeher nuk ka pas ndonji problem, ndonji pengese apo kundershtrim e asaj paluajtshmerie e as ne lokalin e ndertuar me vone. Keto rrethana me jane te njohura nga se ne kemi raporte miqesore me paditesin dhe sic e ceka me larte une kam punuar si elektricist ne objektin te cilin paditesi e ka ndertuar.

Nga nje gjendje te ketille faktike te cekur me larte, gjykata konstatoi se paditesi e fitoi te drejten e pronesise ne lokalin afarist, te ndertuar ne parcelen nr. e cila eshte objekt shqyrtimi, ne baze te marveshjes gojore mbi shitblerjen te lidhur ne mes tij dhe shitesit tani te paditurit te pare, ne vitin 1993, duke ia paguar ne tersi cmimin kontraktues dhe duke e poseduar dhe shfrytezuar kete padundeshmeri me gjate se 20 vite, kohe kjo e parapare per fitimin e te drejtes se pronesises ne baze te ndertimit ne token e huaj, e cekur si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi, konform dispozites se nenit 24 te Ligjit mbi Marredheniet Themelore Juridike - Pronesore, pasi qe e paditura e dyte nuk ka kundershuar ne asnje menyre veprimet e paditsit perkitazi me ndertimin, edhe pse ka pasur dijeni per ndertimin e objektit afarist ne ate palujtshmeri qysh ne vitin 2003.

Paditsi te drejten e pronesise ne kete patundeshmeri e kishte fituar edhe konform nenit 73 te Ligjit per Marredheniet Detyrimore, pasiqe kontraten gojore te lidhur ne mes tij dhe shitsit e kishte permbushur ne teresi, pasiqe e kishte paguar cmimin kontraktues dhe poashtu kishte hyr ne posedim dhe shfrytezim te kesaj patundeshmerie menjehere pas blerjes se te njejtës qysh prej vitit 1993, duke mos qene i penguar nga askush e te cilen edhe sot e shfrytezon.

Kete gjendje te tille faktike gjykata e vertetoi ne baze te deshmive te deshmitareve dhe i qe te dy nga i te cileve ua fali besimin e plote, pasiqe te njejtat ishin bindese dhe perputheshin ne teresi ne mes veti por edhe me gjendjen ne teren.

Gjykata ne kete rast i aplikoi dispozitat e LMTHJP, nga se raporti juridik konkret i qeshtjes kontestimore eshte sajuar ne kohen kur ne aplikim ka qene ligji i lartecekur.


Vendimin qe secila pale ti barte shpenzimet e veta te procedures kontestimore, gjykata e mori konform nenit 459.1 te LPK-se.

Nga arsytet e paraqitura me larte, u vendos si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE

C.nr.465/2014, dt.16.07.2015.

*Taka pa akte
- 25 €
Aceri*



Gjyqtari,
Skender Shala

KESHILLE JURIDIKE: Kunder ketij aktgjykimi eshte e lejuar ankesa, ne afatin prej 15 (pesembedhjet) diteve, nga dita e pranimit, Gjykates se Apelit ne Prishtine, e permes kesaj gjykate.

Saktesine e pershkrimt e verteton:

13. 07 2015
[Signature]